

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjenerali Eric Wendt shkel në tokën shqiptare, ambasadori i ri amerikan mbërrin në Tiranë (AXHENDA)
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/gjenerali-eric-wendt-shkel-ne-token-shqiptare-ambasadori-i-ri-amerika-i402033
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 13:30:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 13:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5fa03cb8e166f208bfe5bf58bc5fd977aa4fcee3b4e9b13b4b1c8627c748632c
TEKSTI	0fe29529a24a64b2a9263d76f8041c4ef277ef2f6f1f00d7050d45c6d1174c35
PAMJA	4053c45c50962dc0ebf8f9140a8fc39d2dc5b6493155983242f6f4dac7d98f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5e33772051816aa27c82547f7362ebfbf5d89bf2aa6fd42c8c4afbd9747abba3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e555023da
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5e33772051816aa27c82547f7362ebfbf5d89bf2aa6fd42c8c4afbd9747abba3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Aktualitet

25 Shtator 2026, 15:27

Gjenerali Eric Wendt shkel në tokën shqiptare, ambasadori i ri amerikan mbërrin në Tiranë (AXHENDA)

Shkruar nga Newsbomb



Eric Wendt

Ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Eric Wendt, ka shkelur këtë të premte në tokën shqiptare. Burime për mediat konfirmojnë se i përzgjedhuri i presidentit Donald Trump për të drejtuar Ambasadën Amerikane në Tiranë ka mbërritur rreth mesditës së 25 shtatorit në aeroportin "Nënë Tereza" në Rinas.

Wendt është pritur në aeroport nga drejtues të protokollit të shtetit, si edhe përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Tiranë. Pas një qëndrimi prej rreth 20 minutash në terminalin VIP, ambasadori i ri amerikan është larguar nga aeroporti, ndërsa makina me flamurin e Shteteve të Bashkuara është nisur në drejtim të kryeqytetit.

Ndalesa e parë e tij në Tiranë pritet të jetë selia e Ambasadës Amerikane, aty ku Wendt do të nisë kontaktet e para pas mbërritjes në Shqipëri.

Sakaq mësohet se paraditja e së shtunës do ta gjejë Eric Wendt në Pallatin e Brigadave, ku do të dorëzojë letrat kredenciale. Përveç ceremonisë së dorëzimit të kredencialeve, parashikohet edhe një takim mes presidentit Bajram Begaj dhe ambasadorit të ri amerikan, i cili pritet të jetë një nga takimet e para zyrtare të Wendt në Shqipëri.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

Qëllol me lugë e shishe të rinjtë protestues, reagon Delina Fico: Po haja qofte dhe po pija birra, s'përbajta veten kur i përmendën Bledit "gruan"



Politikë

Këshilli Bashkiak i Tiranës me letër SPAK-ut dhe Burgjeve, kërkon që Erion Veliaj të dalë nga burgu: Na i sillni kryebashkiakun, është e nevojshme

Zbulu më shumë artikuj >

Të hënën, ambasadori i ri amerikan pritet të vijojë axhendën e tij me një vizitë në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ku do të zhvillojë takimin e parë me ministrin Ferit Hoxha.

Ndërkohë, më 2 tetor, Ambasada Amerikane në Tiranë pritet të organizojë edhe ceremoninë e prezantimit të ambasadorit të ri, e cila do të mbahet në një hotel në qendër të kryeqytetit.

Ish-gjenerali amerikan vjen në Tiranë me një axhendë të përcaktuar dhe me disa prioritetë të bëra publike prej tij gjatë dëgjësës në Senatin Amerikan. Në atë seancë, Wendt renditi katër drejtimet kryesore ku do të përqendrohet gjatë mandatit të tij në Shqipëri.

Në fokusin e parë është mbrojtja e qytetarëve amerikanë dhe avancimi i interesave të Shteteve të Bashkuara, ku përfshihet edhe mbështetja për Shqipërinë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ndërkombëtar.

Një tjetër çështje e rëndësishme lidhet me sigurinë dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të NATO-s. Wendt ka deklaruar se do të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për rritjen e shpenzimeve në fushën e mbrojtjes, me objektivin e arritjes së nivelit 5% të PBB-së deri në vitin 2035.

Në axhendën e tij është edhe diplomacia ekonomike dhe tregtare. Ambasadori i ri amerikan ka nënvizuar rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve ekonomike dhe krijimit të më shumë mundësive për bizneset dhe investimet amerikane në Shqipëri.

Ndërsa prioriteti i katërt lidhet me vetë stafin e Ambasadës Amerikane. Wendt e ka cilësuar këtë si "faktor i njerëzor", duke theksuar nevojën për përdorimin e mënyrave standarde dhe kreative në funksion të punës së përfaqësisë diplomatike.

Kush është Eric Wendt?

Me mbi 34 vite shërbim aktiv, Wendt ka mbajtur një sërë pozicionesh të larta drejtuese, duke menaxhuar organizata komplekse me mijëra personel ushtarak, civil dhe ndërinstytucional. Përveç karrierës ushtarake, ai ka kontribuar edhe në diplomaci, duke shërbyer për dy vite në Departamentin Amerikan të Shtetit si pjesë e Ambasadës së SHBA-ve në Jerusalem. Në këtë rol, ai drejtoi një koalicion me tetë vende si Koordinator i Sigurisë për Izraelin dhe Autoritetin Palestinez, duke raportuar drejtpërdrejt te Sekretari i Shtetit.

Departamenti i Shtetit thekson se përvoja e tij e gjerë në lidership, aftësia për të menaxhuar struktura shumëkombëshe dhe ndërinstytucionale, si dhe njohja e thellë e rajonit evropian e bëjnë Wendt një kandidat shumë të kualifikuar për të përfaqësuar Shtetet e Bashkuara në Shqipëri.

Në aspektin akademik, Wendt ka përfunduar studimet Bachelor në Universitetin e Kalifornisë, Santa Barbara, si dhe një diplomë Master në Shkollën Pasuniversitare të Marinës në Monterey, Kaliforni. Ai zotëron gjithashtu njohuri në gjuhën arabe dhe koreane.

Për kontributin e tij ndër vite, ai është vlerësuar me një sërë dekoratash dhe çmimesh prestigjioze, përfshirë Medaljen e Shërbimit të Shquar të Mbrojtjes, Medaljen e Shërbimit të Shquar, Medaljen e Yllit të Bronzit dhe Çmimin e Nderit të Lartë të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu





🕒 E Premte 15:03

Plagosje me armë zjarri te “Zogu i Zi”, një shtetas nga Kosova dërgohet me urgjencë drejt Traumës (DETAJET E PARA)



Aktualitet

“Nuk do t’i lëmë të na bëjnë të fortin”, si degradoi nga TikTok-u sherri mes të miturve në Yzberisht, mblohdën shokët dhe shkuan të “sqarohen”

🕒 E Premte 13:58



Aktualitet

Turistja çeke dhe i dashuri i saj humbin bagazhet në autobusin e Shkodrës, denoncojnë në internet “Kompaninë BERISHA”: Çantat tona ranë rrugës, kur na i kthyen ishin të hapura (FOTO)

🕒 E Premte 13:44



🕒 E Premte 13:35

Parandalohet tragjedia në Yzberisht, 23 të mitur shkojnë të rrihen me njëri-tjetrin, me vete kishin shkopa bejsbolli, blutë e 6-tës ndërhyjnë menjëherë



Aktualitet



Aktualitet

NUK KA MË SEKRETE! Sali Berisha nxjerr FOTON e drejtorit të Operacionales në SHISH dhe shkruan: Te lokali i tij në Bërzhitë takoheshin Gysi dhe Vlora

E Premte 13:27

Vlora Hyseni nën akuzë në Shqipëri, mediat në Rumani japin ALARMIN: Është stërvitur nga Gjenerali i Zi, Coldea ishte këshilltar i kryeministrit Rama dhe shef i spiunazhit rumun

E Premte 13:04



E Premte 12:27

Dy 22 vjeçarët me parcelë kanabisi në Skrapar, i ruanin bimët me kallashnikov, sapo panë Policinë hodhën armën dhe u futën në pyll



Aktualitet

VIDEO/ "Të q*fsha motrën", shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë

E Premte 12:03



Aktualitet

"Pushtetet janë të ndara, por shteti është një", kryegjyqtari Sokol Sadushi kundër idesë së Edi Ramës për të shqyrtuar pagat: Kushtetuta nuk negociohet, Gjykata ka folur (FJALA E PLOTË)

E Premte 11:05



E Premte 11:01

Nën akuzë për 700 mijë euro të vjedhura, gjykata liron nga burgu dhe çon në

shtëpi ish-drejtoreshen e Postes se Durrësit



Aktualitet

Revista greke shkruan për historinë e Samir Manes: Miliarderi i vetëm i



Aktualitet

Nuk ranë dakord për çmimin e servisit të makinës, Policia zbardh

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.